

## **KREU I**

### **Dispozitat e pergjithshme**

#### **Neni 1**

##### **Parimet themelore**

Bashkia e Shkodrës është një Ent autonom lokal, është i përfaqësuar sipas parimevet të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe të Ligjit nr. 8652, dt. 31-07-2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Vetëqeverisja e Bashkisë, në përputhje me parimet e përgjithshme të Ligjit, realizohet me mundësitë dhe institutet e parashikuara në këtë Statut, i cili përcakton parimet themelore e organizimit të Entit.

#### **Neni 2**

##### **Misioni i Bashkisë**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit. Bashkia nxit zhvillimin dhe përparimin civil, social dhe ekonomik të komunitetit, nëpërmjet bashkëpunimit me gjithë personat publikë dhe privatë, duke ndikuar në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të faktorëve sociale, ekonomike dhe sindakale në administrimin e qytetit duke vepruar sipas parimevet të ratifikuara ka Kushtetuta:

- 1) kapërcimi i problemeve ekonomike, sociale, territoriale që i përkasin Bashkisë;
- 2) nxitja e rolit social të iniciativës ekonomike, publike dhe private, edhe përsa i përket zhvillimit të shoqatave ekonomike dhe të bashkëpunimeve;
- 3) mbështetja në realizimin e një sistemi global dhe i plotësuar për sigurinë sociale dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut, edhe nëpërmjet përfshirjes së organizatave dhe shoqërisë civile në përgjithësi, me qëllim të krijimit të një gjendje social-ekonomike të stabilizuar.
- 4) mbrojtja dhe zhvillimi i pasurive të natyrës, të ambientit, historike dhe kulturore, që gjenden në territorin e Bashkisë, që ti garantohet shoqërisë një cilësi e jetës sa më e mirë;
- 5) ofrimi sa më i mirë i shërbimevet institucionale për t’u bërë përfitueshme për gjithë njerëzit që kanë nevojë dhe mbështetja në forma të ndryshme ndihmese për kategoritë më në nevojë.
- 6) Mbrojtja dhe nxitja e traditave dhe të vlerave më të mira që i përkasin artit dhe kulturës , nëpërmjet krijimit të strukturave të cilat mbrojnë trashigiminë kulturore dhe nxisin zhvillimin e mëtejshëm të saj.
- 7) marrja e masave për të pasur mundësi të barabarta për burrat dhe gratë.
- 8) Nxitja e aktivitetet sportive dhe të motit të lirë, tue ndihur shoqërizimin rinor dhe ndër pjeqtë.

#### **Neni 3**

##### **Qëllimi i Statutit**

Qëllimi i këtij statuti është përcaktimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i normave dhe rregullave bazë, për procesin e marrjes së vendimeve nga ana e organeve të bashkisë, si dhe të përfshirjes në vendimarrje të komunitetit.

#### **Neni 4** **Emblema, flamuri dhe vula**

Emblema dhe flamuri i bashkisë vendosen në sallën e mbledhjeve të keshillit bashkiak, në ambjentet e administratës së bashkisë, në hyrjen e ndërtesës së bashkisë dhe në pronat e saj, në automjetet e bashkisë, në çdo dokument që del nga bashkia si dhe në faqen e internetit. Emblema e bashkisë mund të përdoret edhe nga institucionet apo ndërmarrjet në varësi të bashkisë.

Modeli i emblemës dhe flamurit të bashkisë si dhe mënyrës së përdorimit të tyre rregullohet me vendim këshillit bashkiak.

Modeli i vulës rrumbullake të bashkisë përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

#### **Neni 5** **Titujt dhe medaljet**

Këshilli bashkiak me vendim përcakton titujt dhe medaljet si dhe rregullat për dhënjen e tyre personave me kontribute, sidomos për qytetin në fusha të ndryshme.

Këshilli bashkiak mund të japë titullin “Qytetar Nderi”, personave që kanë kontribute, veçanërisht të shquara për qytetin.

### **Kreu II** **Parimet e pergjithshme**

#### **Neni 6** **Parimi i autonomise vendore**

1. Bashkia e ushtron pushtetin e sajë ne bazë te parimit të autonomisë vendore. Autonomia vendore është e drejta dhe aftësia efektive e komunitetit /bashkësisë vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë së tyre, të gjitha çështjet publike që ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare i lënë në kompetencë të saj.
2. Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat të përbërë nga anëtarët e zgjedhur të tij, nëpërmjet votimit të lirë, të fshehtë, të barabartë e të drejtpërdrejtë si dhe nga organet ekzekutive që janë përgjegjëse para këshillit. Kjo dispozitë nuk i pengon banorët të mblidhen në kuvende, referendume apo forma të tjera të pjesmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre, aty ku lejohet nga ligji.
3. Bashkia gëzon brenda ligjit, lirinë e plotë për të ushtruar iniciativën e vet vendimmarrëse për çdo çështje, që nuk është jashtë kompetencës së saj apo që mund ti jetë dhënë në kompetencë një autoriteti tjetër.
4. Bashkia ka të drejtën dhe detyrimin të marrë iniciativa si dhe të shprehet, gjatë procesit të planifikimit të vendimmarrjes së çdo lloji nisme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi prek çështjet publike me interes vendor.

## **Neni 7**

### **Parimi i pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje**

1. Bashkia, siguron pjesmarrjen sa më të gjerë të komunitetit dhe banorëve në vendimmarrjen për çështjet vendore, me format dhe instrumentat e duhura.
2. Asnjë akt juridik i bashkisë, që ka për qëllim kufizimin e kësaj të drejtë, nuk mund të miratohet.

## **Neni 8**

### **Parimi i ligjshmërisë**

Këshilli bashkiak, kryetari i bashkisë, nëpunësit e emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit me kontratë të bashkisë, të gjitha vendimet apo veprimet që ata ndërmarrin duhet ti bazojnë në ligjet në fuqi dhe në këtë statut.

## **Neni 9**

### **Parimi i transparencës**

1. Anëtarët e këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë, nëpunësit e emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit me kontratë të bashkisë, duhet të jenë sa më shumë që të jetë e mundur të hapur dhe transparentë për të gjitha vendimet apo veprimet që ndërmarrin.
2. Ata në çdo rast, duhet të japin arsyet, për vendimet dhe veprimet e tyre, apo mosveprimet, dhe të kufizojnë informacionin vetëm në rastet e veçanta të parashikuara me ligj.

## **Neni 10**

### **Parimi i informimit të publikut**

Bashkia garanton dhe zbaton në çdo kohë dhe me çdo mënyrë, të drejtën e qytetarëve për informimin publik.

## **Neni 11**

### **Parimi i ndalimit të konfliktit të interesave**

1. Anëtarët e këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë, nëpunësit e emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit me kontratë të bashkisë, kanë për detyrë të deklarojnë çdo interes privat që ka lidhje apo mund të ndikojë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre publike.
2. Ata duhet të ndërmarrin çdo hap në mënyrë që të shmangin çdo lloj konflikti interesi, që bie ndesh me realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre publike.

**Neni 12**  
**Parimi i llogaridhënies**

Anëtarët e këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë, nëpunësit e emeruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit me kontratë të bashkisë, japin llogari për vendimet dhe veprimet e tyre përpara publikut dhe duhet ti nënshtrohen çfarëdolloj kontrolli që është i domosdoshëm për funksionet e tyre.

**Neni 13**  
**Parimi i mbrojtjes së interesit publik**

1. Anëtarët e këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë, nëpunësit e emeruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit me kontratë të bashkisë, duhet të marrin vendime dhe të veprojnë në përmbushje të detyrave të tyre, vetëm në interesin publik.
2. Ata kurrësi nuk duhet të veprojnë në mënyrë të tillë, me qëllim për të siguruar përfitime financiare, përfitime materiale apo përfitime të çdolloji tjetër, për veten, familjen, fisin apo miqtë e tyre.

**Kreu III**  
**Vetqeverisja Vendore dhe Organet Vendore**

**Neni 14**  
**Vetqeverisja vendore**

Vetqeverisja vendore në bashki ushtrohet nëpërmjet organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të saj, si dhe nga vetë banorët nëpërmjet referendumeve vendore, si dhe çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga ligjet në fuqi apo nga ky statut.

**Neni 15**  
**Organet vendore**

1. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak dhe organi ekzekutiv është kryetari i bashkisë.
2. Bashkia është person juridik. Ky autoritet realizohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe të kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrim të funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

**Neni 16**  
**Këshilli Bashkiak**

1. Këshilli i bashkisë përcakton drejtimin politiko – administrativ të bashkisë, adapton aktet bazë të parashikuara nga ligji dhe kontrollon zbatimin e tyre.
2. Të drejtat ekskluzive të këshillit bashkiak në emer të bashkisë jane :
  - pronat publike të bashkisë dhe ushtrimi i çdo të drejte të ligjshme për to,

- financat dhe përcaktimi i normave të sigurimit të të ardhurave dhe të treguesve të përdorimit të fondeve, Brenda kuadrit ligjor,
- krijimi i subjekteve për ushtrimin e kompetencave dhe plotësimin e detyrave ligjore të bashkisë, me interes për komunitetin,
- miratimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të çdo forme delegimi të kompetencave në raport me organe e organizma të çdo niveli.

### **Neni 17** **Kryetari i Bashkisë**

1. Kryetari i bashkisë ushtron ato të drejta dhe siguron plotësimin e të gjitha atyre detyrimeve, që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe që nuk janë në kompetencë të këshillit bashkiak.
2. Kryetari përgjigjet përpara këshillit për shkallën e plotësimin të funksioneve, kompetencave e detyrave ligjore dhe të vendimeve të këshillit sa herë që i kërkohet nga ana e tij.

### **Neni 18** **Anëtarët e keshillit bashkiak**

1. Anëtarët e këshillit bashkiak, ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me ligjet në fuqi dhe me këtë statut, duke u udhëhequr në veçanti nga parimet e përgjithshme të këtij statuti.
2. Anëtari i këshillit bashkiak, është i lirë dhe i pavarur në zgjedhjen e alternativës për votën e tij, pamvarësisht se kujt grupimi politik i përket. Alternativa për votën që duhet të japi anëtari i këshillit bashkiak, udhëhiqet në çdo rast nga parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe komunitetit.

### **Neni 19** **Shpërblimi i anëtarëve të këshillit bashkiak**

1. Anëtarët e këshillit bashkiak marrin shpërblim, për kohën e :
  - a) pjesmarrjes në mbledhjet e këshillit bashkiak,
  - b) pjesmarrjes në mbledhjet e komisioneve bashkiake, në të cilat këshilltari është zgjedhur anëtar,
  - c) pjesmarrjes në grupet e punës ad-hoc të ngritura për probleme të veçanta, në të cilat këshilltari është i zgjedhur anëtar,
  - d) përfaqësimit të bashkisë jashtë kufijve administrative të saj, kur ai është deleguar nga këshilli bashkiak.
2. Parimet e veçanta të pagimit të shpërblimit për këshilltarët, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 20** **Grupet politike**

1. Këshilltarët mund të krijojnë ” Grupe Politike ” të këshilltarëve, të cilat nuk mund të përbëhen nga më pak se tre këshilltarë.
2. Grupi i vë në dispozicion menjëhere kryetarit të këshillit bashkiak, dokumentin e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit, që përmban informacionin për krijimin e grupit, si dhe listën e personave të autorizuar për të përfaqësuar grupin. Në çdo rast të ndryshimit të anëtarësisë së grupit, informohet menjëhere kryetari i këshillit bashkiak.
3. Të gjitha grupet politike, gëzojnë të drejta dhe detyrime të barabarta.
4. Kostot për funksionimin e grupit politik, mbulohen nga buxheti i këshillit bashkiak.
5. Me kërkesë të grupit, kryetari i këshillit vë në dispozicion të grupit ambjentet e nevojshme për funksionimin e tij.

## **Neni 21**

### **Interpelancat**

1. Interpelanca është kërkesa me shkrim për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e kryetarit të Bashkisë ose drejtuesve të tjerë të saj, apo enteve dhe ndërmarrjeve që varen prej Bashkisë, lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre. Interpelanca paraqitet nga cdo këshilltar apo grup këshilltarësh.
2. Interpelanca i paraqitet kryetrit të Këshillit Bashkiak, i cili nëpërmjet sekretarit të Këshillit Bashkiak vë në dijeni menjëherë organin të cilit i drejtohet.
3. Në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit vendoset me mirëkuptim nëse një interpelancë do shqyrtohet me debat ose pa debat në Këshill. Në rastin kur vendoset që interpelanca të zhvillohet me debat përcaktohet edhe koha e debatit.
4. Interpelancat vihen në rendin e ditës së mbledhjes së këshillit jo më vonë se dy muaj nga paraqitja e tyre. Nuk mund të vihen në rendin e ditës së të njëjtës mbledhje më shumë se një interpelancë e bërë nga i njëjti këshilltar.
5. Këshilltari që ka paraqitur një interpelancë, ka të drejtën e shpjegimit të saj për një kohë jo më të gjatë se 10 minuta dhe, pas deklarimit të organit që interpelohet shpreh për një kohë jo më të gjatë se 15 minuta, arsyet për të cilat mbetet i kënaqur ose jo me përgjigjen e dhënë.

## **Kreu IV**

### **Proçesi i vendimmarrjes**

## **Neni 22**

### **Iniciativa e paraqitjes së projekt-akteve**

E drejta e paraqitjes së projekt – vendimeve apo projekt- urdhëresave në këshill bashkiak, i takon :

- a) Kryetarit të bashkisë
- b) Këshilltarë të vecantë
- c) Komisioneve të përhershme këshillit bashkiak
- d) Qytetarëve me të drejtë vote brenda Bashkisë Shkodër, numri i të cilëve përcaktohet në rregulloren e Keshillit Bashkiak.

## **Neni 23**

### **Procedura e paraqitjes dhe e shqyrtimit te projekteve në Këshill**

1. Projektet shoqërohen me relacionet përkatëse, ku jepen sqarime për motivet përse propozohet akti dhe për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të vecanta. Vetë projekti hartohet në formën e duhur të një akti normativ. Ai duhet të firmoset nga hartuesi i tij, nga juristi që konfirmon bazueshmërinë ligjore të këtij projekti dhe nga titullari përkatës.
2. Projekt- aktet duhet të shoqërohen me dokumentat e nevojshëm, që lejojnë vlerësimin e domosdoshmërisë së miratimit të projekt - vendimit të propozuar, si dhe Deklaratën e mbështetjes së projekt – vendimit të propozuar, nga numëri i nevojshëm i qytetarëve apo i Grupeve Politike .
3. Projekt-aktet duhet të dorëzohen zyrtarisht, shoqëruar me një shkresë përcjellëse, tek Sekretari i Këshillit i cili rregjistron marrjen në dorëzim në librin përkatës. Projekt-aktet e administratës së Bashkisë (si dhe shkresa përcjellëse e tyre) duhet të jenë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në mungesë të tij, me urdhër dhe porosi nga ai firmosen nga zv/kryetari i Bashkisë.
4. Sekretari i këshillit të bashkisë, vërteton mbi projekt – vendim, datën e marrjes së projekt – vendimit të propozuar. N.q.s vërehen mungesa formale në projekt – vendimin e propozuar, atëherë kryetari i këshillit bashkiak ja kthen projekt – vendimin propozuesve, me qëllim plotësimin e mungesave formale.
5. Kryetari i këshillit pasi njihet me projekt-aktet e paraqitura nëpërmjet sekretarit u a shpërndan ato komisioneve të përhershme, në përputhje me karakterin e përkatësinë e tyre duke përcaktuar cili komision do të jetë “kryesor”. Sekretari i këshillit organizon dhe koordinon me komisionet shqyrtimin e projektit, ndjek ruajtjen e afateve dhe përgatit materialet për mbledhjen e këshillit.
6. Komisionet e përhershme në raportet me shkrim që paraqesin deklarohen për domosdoshmërinë e aktit, dobinë e tij, mundësinë financiare përplotësimin e tij. Ato bëjnë propozime të argumentuara për të pranuar projektin ashtu sic është apo duke i bërë ndryshime, plotësime apo duke mos i pranuar. Kur propozuesi i projektit nuk është dakord me raportin e komisionit, ai mund të paraqesë një raport plotësues.
7. Krahas komisioneve që kanë marrë projekt-aktet në shqyrtim, Sekretari i Këshillit i fton paraprakisht në zyrë të tij edhe kryetarët e komisioneve të tjera përhershme për t’u njohur me projekt-aktet që do të paraqiten në mbledhjen e ardhshme të këshillit, pavarësisht se nuk janë objekt i shqyrtimit të tyre. Në rast se një kryetar komisioni gjykon se një projekt-akt i caktuar mund të jetë edhe objekti i shqyrtimit të atij komisioni, atëherë ai nëpërmjet sekretarit të këshillit lajmëron aëtarët e komisionit dhe bën shqyrtimin sipas procedurës brenda afateve përkatëse.
8. Kur komisioni i përhershëm i ngarkuar për shqyrtimin e projekt-aktit nuk arrin të mblidhet ose nuk paraqet relacion me shkrim për çështjen në fjalë atëherë sekretari i këshillit nuk e fut këtë çështje në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të këshillit.
9. Pas mbarimit të procedurave sa më sipër, sekretari i këshillit me miratim të kryetarit thërret mbledhjen e Kryesisë së Këshillit. Kryesia e Këshillit im pasi njihet nga sekretari me dokumentacionin e plotë që do të paraqitet për shqyrtim në mbledhjen më të afërt të Këshillit merr vendimet e duhura në dobi të ecures efektive të mbledhjes së Këshillit. Në përfundim Kryesia e Këshillit përcakton rendin e ditës si dhe datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.
10. Projekt- aktet do t’i nënshtrohen debatit në këshill sipas rradhës që është parashikuar në rendin e ditës. Debati paraprihet nga paraqitja që bëhet nga propozuesi, të arsyeve që kanë përcaktuar propozimin e projektit si dhe nga paraqitja e relacionit nga komisioni i

përhershëm. Mbas diskutimit të këshilltarëve, propozuesi ka të drejtë të marrë fjalën përpara mbylljes së debatit në parim.

## **Neni 24**

### **Votimi**

1. Votimi është individual. E drejta e votës nuk delegohet. Votohet me fjalët “pro”, “kundër” dhe “abstenoj”. Votimi kryehet i hapur ose i fshehtë. Votimi i hapur kryhet nëpërmjet ngritjes së dorës me votim të përgjithshëm, me votim nominal emër për emër dhe me mjete elektronike. Me votim nominal njëri nga antarët e sekretarisë lexon emër për emër këshilltarët dhe secili këshilltar me të dëgjuar emrin përgjigjet “pro”, “kundër” ose “abstenoj”. Votimi i fshehtë kryhet me fletë votimi. Fletët e votimit hartohen drejtëpërdrejtë në këshill. Për organizimin e votimit ngarkohet sekretaria ose formohet komision i vecantë për shqyrtimin e votimit, komision i përbërë nga pjestarë të grupeve të ndryshme të këshilltarëve.
2. Kërkesa për votim nominal ose të fshehtë formulohet në kohën që drejtuesi i mbledhjes mbyll diskutimet dhe deklaron se do të kalohet në votim. Cdo këshilltar ka të drejtën e propozimit për përcaktimin e mënyrës së votimit. Propozimi hidhet në votë pa debat.
3. Propozimi për votim të fshehtë bëhet duke përcaktuar problemin dhe arsyetimin për këtë propozim. Votimi i fshehtë nuk bëhet për çështjet që kanë të bëjnë me vendime financiare, me buxhetin si dhe me vendime të tjera që sjellin pasoja financiare.
4. Para fillimit të procesit të votimit drejtuesit e grupeve mund të kërkojnë të tërhiqet grupi për konsultim për një kohë jo më shumë se 10 minuta.
5. Votimi i akteve fillimisht bëhet në parim dhe pastaj, nëse e kërkon këshilli bëhet në terësi ose nen për nen. Gjatë procesit të votimit nuk i jepet fjala asnjë këshilltari.
6. Në rastin e votimit nominal lista e këshilltarëve votues me shënimin e votës “pro”, “kundër” ose “abstenim” të secilit këshilltar, publikohet së bashku me materialet e mbledhjes.
7. Në se para fillimit të procesit të votimit ose gjatë tij vërehet se nuk është kuorumi i nevojshëm që kërkon votimi, atëherë ai shtyhet, por jo më tepër se 1 orë. Në rast se edhe pas kalimit të kësaj kohe nuk realizohet kuorumi, drejtuesi i mbledhjes cakton një datë tjetër duke deklaruar edhe oren e votimit.
8. Kur bëhet votim i fshehtë, sekretaria e këshillit (ose komisioni i vecantë i ngritur) bën administrimin e votimit dhe shpall rezultatin e tij. Rezultatet e votimit pasqyrohen në proces-verbalin e votimit dhe firmoset nga antarët e sekretarisë (ose të komisionit të vecantë).
9. Nëse një antar i komisionit të votimit ka vërejtje për procesin e votimit, mënyrën e numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultatit, ai i shkruan ato në proces-verbalin e votimit. Sekretari i këshillit (ose kryetari i komisionit) i bën të ditur të gjithë këshilltarëve përmbajtjen e proces-verbalit të votimit, rezultatin e tij dhe vërejtjet e mundshme të një ose disa antarëve të komisionit të cilat janë të rregjistruara në proces-verbal.

## **Kreu V**

### **Pjesmarrja e komunitetit në vendimmarrje**

## **Neni 24**

### **E drejta e pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje**



Pjesmarrja e komunitetit në vendimmarrje është e garantuar. Kjo e drejtë e komunitetit realizohet nëpërmjet, referendumeve vendore, paraqitjes së projekt-vendimeve në këshillin bashkiak, si dhe nëpërmjet çdo lloj forme tjetër që njohin ligjet në fuqi si dhe ky statut.

## **Neni 26**

### **Seancat e këshillimit, konsultimet**

1. Për të lehtësuar përfshirjen e interesave të ndryshme dhe për të favorizuar shprehjen e pavarur të kërkesave të grupeve shoqërore në rrugë institucionale, bashkia organizon seanca të këshillimit me komunitetin sipas fushave, aktiviteteve ose interesave të cilat janë kompetencë e saj.
2. Në rastet kur për probleme të veçanta, mendohet se duhet marrë një opinion i komunitetit organizohen konsultime me komunitetin. Ky konsultim, përveç të tjerave mund të realizohet nëpërmjet asambleve, komisioneve qytetare, pyetsorëve, mjeteve informatike apo sondazhit të opinioneve.
3. Kur ky konsultim ka të bëjë me interesa të përgjithshme të popullsisë rezidente, shqyrtimi i problemeve të dala bëhet detyrimisht nga ana e këshillit bashkiak.
4. Me rregulloren e posaçme që miratohet nga këshilli, përcaktohen rastet e seancave të këshillimit dhe të konsultimeve me komunitetin, ndarja sipas sektorëve të aktiviteteve dhe interesave, procedurat dhe mënyra e trajtimit të problemeve që dalin, në mënyrë që të sigurohet përfaqësueshmëria, transparenca dhe dobishmëria konkrete e tyre.

## **Neni 27**

### **Projekt Vendimet, Kërkesa, Peticionet dhe propozimet**

1. Të gjithë banorët e bashkisë që kanë mbushur moshën 18 vjeç, kanë të drejtën të paraqesin projekt-vendime, kërkesa, peticione dhe propozime drejtuar organeve përfaqësuese e te zgjedhura të bashkisë.
2. Mënyra e praqitjes së dokumenteve të mësipërm, bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, ligjin për informimin publik si dhe me këtë statut.

## **Kreu VI**

### **Informimi publik dhe Transparenca**

## **Neni 28**

### **Informimi publik dhe transparenca**

1. Bashkia siguron informacion të plotë rreth aktivitetit të zhvilluar dhe shërbimeve të ofruara prej saj dhe strukturave që realizojnë shërbime publike, sipas modaliteteve të përcaktuar në rregulloret dhe dispozitat ligjore në fuqi.
2. Bashkia përshtat dhe organizon qarkullimin sa më të gjerë të informacionit brenda strukturave të saj dhe në raport me organet e tjera jashtë saj dhe në veçanti me strukturat e tjera shtetërore dhe publike.
3. Me synimin për të garantuar transparencën në aktivitetin e saj, bashkia bën publike për komunitetin në një mënyrë sa më të qartë, sa më të thjeshtë dhe sa më të kuptueshme :
  - a. buxhetin vjetor ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet sipas strukturës buxhetore të përcaktuar nga organet kompetente të specializuara.
  - b. Raportin vjetor për zbatimin e buxhetit të miratuar nga këshilli...

- c. Të dhënat ekonomike, financiare, sociale në lidhje me nivelin e shërbimeve dhe programeve të zhvillimit, në veçanti për ato fusha që lidhen me destinacionin e burimeve financiare e materiale që disponohen.
- d. Parametrat e caktuara si kritere për shpërndarjen e burimeve midis sektorëve të ndryshëm të aktiviteteve të bashkisë.
- e. Të dhënat për kushtet e përgjithshme të jetesës në territorin e saj.
- f. Kriteret, modalitetet e përdorura dhe zgjidhjet e dhëna për sipërmarrjet e punëve publike, sipas legjislacionit të prokurorimit publik.

## **Kreu VII**

### **Financat dhe Asetet Vendore**

#### **Neni 29**

##### **E drejta e vendimmarrjes**

1. Këshilli bashkiak, ushtron të drejtën ekskluzive të vendimmarrjes mbi financat dhe asetet e bashkisë. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë statut.
2. Çdo vendimmarrje e këshillit bashkiak, që ka të bëjë me vlera të mëdha financiare apo me shitje të aseteve vendore, duhet të sigurojë paraprakisht mendimin e komunitetit. Format dhe mënyrat për sigurimin e mendimit të komunitetit, miratohen me rregullore të veçantë.
3. Çdo vendimmarrje e këshillit bashkiak, për financat dhe asetet vendore, duhet të sigurojë në veçanti zbatimin e parimit të transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik.
4. kryetari i bashkisë, në zbatim dhe në përputhje me vendimet e këshillit bashkiak, ligjet në fuqi dhe me këtë statut, administron financat dhe asetet e bashkisë.

#### **Neni 30**

##### **Politikat për financat dhe asetet**

Këshilli bashkiak, miraton politikat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të menaxhimit të financave dhe aseteve të bashkisë, në përputhje me planet strategjike të zhvillimit të bashkisë.

#### **Neni 31**

##### **Buxheti vjetor**

Financat e bashkisë përfshihen në buxhetin vjetor të bashkisë. Buxheti i bashkisë është plani vjetor i të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë dhe krijohet në përputhje me ligjet në fuqi.

## **Kreu VIII**

### **Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar, kombëtar rajonal dhe lokal**

1. Bashkia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut, në të mirë e në dobi të qytetit dhe komunitetit, ka të drejtë të bashkëpunojë me njësi vendore të shteteve të huaja dhe organizma ndërkombëtare.
2. Ky bashkëpunim kryhet nëpërmjet, binjakëzimeve, aderimit në shoqata ndërkombëtare të autoriteteve lokale dhe rajonale, realizimit të projekteve ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe, shkëmbimeve të delegacioneve si dhe pjesëmarrjes në konferenca, seminare, ëorkshope e panaiere.

3. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat mund të emërtohen si, marrëveshje binjakëzimi ose bashkëpunimi, protokolle ose memorandume mirëkuptimi.

4. Këshilli bashkiak, miraton rregullore të veçantë që në mënyrë të hollësishme sanksionon çështjet e mësipërme.

### **Neni 33** **Bashkëpunimi Kombëtar**

1. Bashkia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut, dhe në të mirë e dobi të qytetit dhe komunitetit, ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione shtetërore, ente publike, subjekte private dhe OJF që veprojnë në nivelin kombëtar.

2. Bashkëpunimi do të kryhet në çdo lloj fushe që paraqet interes vendor dhe në çdo lloj forme të lejuar nga ligji. Iniciativat e bashkëpunimit mund të ndërmerren nga vetë organet e bashkisë, por edhe me propozim të banorëve dhe komunitetit.

### **Neni 34** **Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe lokal**

1. Bashkia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut, në të mirë e dobi të qytetit dhe komunitetit, ka të drejtë të bashkëpunojë me njësi të tjera vendore të nivelit rajonal dhe lokal.

2. Ky bashkëpunim kryhet nëpërmjet, binjakëzimeve, aderimit në shoqatat kombëtare të autoriteteve lokale dhe rajonale, realizimit të projekteve kombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe, shkëmbimeve të delegacioneve si dhe pjesmarrjes në konferenca, seminare, ëorkshope e panairë.

3. Bashkëpunimi do të kryhet në çdo lloj fushe që paraqet interes vendor dhe në çdo lloj forme të lejuar nga ligji. Iniciativat e bashkëpunimit mund të ndërmerren nga vetë organet e bashkisë, por edhe me propozim të banorëve dhe komunitetit.

## **Kreu IX** **Dispozita te fundit**

### **Neni 35** **Miratimi i statutit**

Ky statut miratohet me kuorumin e votave të parashikuar në rregulloren e Keshillit Bashkiak.

### **Neni 36** **Ndryshimi i statutit**

Ky statut mund të ndryshohet apo shfuqizohet me të njëjtën shumice votash siç është miratuar.

### **Neni 37** **Publikimi i Statutit**

Përmbajtja e Statutit të Bashkisë Shkodër i bëhet i njohur publikut nëpërmjet publikimit me shtypshkrim dhe elektronik në faqen zyrtare Web të Bashkisë Shkodër.

### **Neni 38**

## **Hyrja në fuqi e statutit**

Ky statut hyn në fuqi sipas procedurave të parashikuara në ligjet ekzistues.